

Njoftim për hapjen e studimeve në ciklin II të studimeve:

MASTER PROFESIONAL VITI AKADEMIK 2022 -2023

Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ofron për herë të dytë në vitin akademik 2022-2023, programin e ciklit të dytë të studimeve:

MASTER PROFESIONAL

Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes (Cyber Defence)

Ky program studimi ka për qëllim të formojë gjeneratën e re të profesionistëve ushtarakë dhe civilë, të cilët do të përfitojnë njohuritë e duhura dhe eksperiencat për të zhvilluar sisteme më të sigurta kompjuterike.

Ai synon t'i pajisë studentët me njohuri mbi bazat teorike dhe t'i aftësojë me praktikën e nevojshme në fushën e sigurisë kibernetike të sistemeve të mbrojtjes, për të qenë të suksesshëm në këtë fushë sfiduese, shumë të nevojshme dhe të dobishme.

Aplikimi dhe përzgjedhja për ciklin e dytë të studimeve master profesional do të zhvillohet:

- ✓ Aplikimi: **03-07 tetor 2022;**
- ✓ Shqyrtimi i dosjeve: **10-14 tetor 2022;**
- ✓ Publikimi i listës me renditje së aplikantëve: **18 tetor 2022;**
- ✓ Ankimimi: **19-20 tetor 2022;**
- ✓ Regjistrimi: **20-26 tetor 2022;**
- ✓ Fillimi i procesit mësimor: **01 nëntor 2022**

Aplikimi (E hënë – E premte, **ora 09:00 – 16:00**, pranë sekretarisë mësimore).

KRITERET PËR APLIKIM:

- ✓ Diplomë “Bachelor” (apo e ngjashme me to) të fituar brenda ose jashtë vendit, njohur dhe njehsuar nga struktura kompetente në vend.
- ✓ Diplomë e ciklit të dytë të studimeve ose diplomë e sistemit të vjetër (nëse është program i dytë

studimi).

Kritere të tjera:

- Njohja e gjuhës angleze niveli B2;
- Nota mesatare e studimeve të kryera nga kandidati jo më pak se 7;
- Diploma Bachelor preferohet të jetë në fushën e informatikës (IT), teknologjisë së informacionit (TIK), siguri kibernetike (SK);
- Eksperienca e punës në fushën përkatëse;
- Kandidatët e kualifikuar do t'i nënshtrohen intervistës me gojë;
- Kandidatët do të shpallen fitues sipas rendit zbritës të pikëve të llogaritura me formulë sipas kriterëve përzgjedhëse;
- Pikët maksimale për konkurim në programin e studimit të ciklit e dytë të studimeve me kohë të plotë Master Profesional në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, janë 100 pikë, me ndarje si vijon:

- a. Nota mesatare e ponderuar: 40 (dyzet) pikë
- b. Vlerësimi i dosjes personale: 30 (tridhjetë) pikë
- c. Intervista me kandidatin: 20 (njëzet) pikë
- d. Diplomë të fituar jashtë vendit 5 (pesë) pikë
- e. Diplomë Bachelor në fushën IT, TIK dhe SK 5 (pesë) pikë.

Kufiri minimal i pranimit të konkurentëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master Profesional të jetë 40 pikë.

Kuotat e pranimit janë 20 nga të cilat 15 janë program i parë studimi dhe 5 program i dytë studimi.

Tarifa e studimit është 75.000 lek program i parë dhe 120.000 lek program i dytë dhe paguhet në dy këste.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM:

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij (me një deklaratë noteriale) me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kopje të noterizuar të diplomës së bachelorit apo një program tjetër studimi ekuivalent. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të listës së notave, të njehsuar me origjinalin, ose në mungesë të saj një dokument tjetër zyrtar

mbi bazën e të cilës është kryer njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;

b. Diplomën e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njehsuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP).

Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vendimit 876, datë 03.11.2010 të KM, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinale ose e noterizuar dhe e konfirmuar nga DAR/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

c. Kopje e listës së notave të noterizuar;

d. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, ose pasaportë);

e. Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1 të udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 10, datë 15. 05. 2019, kreu V, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të sekretares mësimore të fakultetit dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe punonjësja e sekretarisë mësimore;

f. Letër motivimi ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet master në siguri kibernetike në fushën e mbrojtjes;

g. Vetë deklaratë për vërtetësinë e të dhënave personale dhe institucionale dhe të dokumenteve të paraqitura nga aplikanti (tërhiqet pranë sekretarisë mësimore dhe nënshkruhet në prani të punonjësit të sekretarisë mësimore);

h. Dëshmi penaliteti;

i. Mandat pagesën e aplikimit;

j. Formulari i aplikimi (sipas formatit të shtojcës nr.6 bashkëlidhur Udhëzimi nr.17, datë 30.07.2019 i MAS;

k. Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr.8 bashkëlidhur Udhëzimi nr.17, datë 30.07.2019 i MAS, për program të dytë studimi;

l. Deklaratë sipas shtojcës nr.5 Udhëzimi nr.17, datë 30.07.2019 i MAS;

m. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim, pasaportë);

n. Dy fotografi personale.